



## RIINTEGRIMI I TË MBIJETUARARVE TË TRAFIKIMIT NËPËRMJET FUQIZIMIT EKONOMIK

Fuqizimi ekonomik është në fokus të punës që D&E bën çdo ditë me vajzat dhe gratë të mbijetuara të trafikimit. D&E i mbështet përfitueset e programit në përpjekjet e tyre për të hyre në tregun e punës, nëpërmjet orientimit dhe mbështetjes nëpërmjet këshillimit për punësim dhe zhvillimin e karrierës. Përfitueset trajnohen individualisht edhe në grup duke i mbështetur, këshilluar dhe duke u dhënë informacion, se si të përgatiten për të hyrë në tregun e punës.

Në këto takime vajzat dhe gratë mësojnë aftësi praktike dhe se si të përgatiten për një intervistë pune. Nëpërmjet trajnimeve stafi i D&E përpiqet që t'u jap atyre këshilla profesionale rreth karrierës dhe edukimit, si dhe përpiqet që ti ndihmojë ato në organizimin e mendimeve, interesave dhe aftësive të tyre.

Ato mbështeten hap pas hapi si të zgjedhin kursin e duhur profesional dhe mbështetja vazhdon deri në punësimin e tyre final, kryerjen e një internshipi apo hapjen e një biznesi.

*"Jam shumë e lumtur që tani unë kam hapur aktivitetin tim dhe kam gjithë pajisjet e nevojshme që më duhen. Është një ëndërr kaq e bukur e bërë realitet, falë mbështetjes që më është dhënë në kohën e duhur"*

*-thotë A. R. njëra nga përfitueset.*



*"Aftësitë që unë kam fituar nëpërmjet trajnimeve dhe mbështetja e madhe që më është dhënë për formimin tim akademik dhe profesional më kanë bërë që të kem jo vetëm më shumë njohuri dhe aftësi, por dhe vetëbesimin se unë do t'ja dal që t'ja nis nga e para jetën time me shumë mbështetje"*  
*-thotë L.M. një tjetër përfituese.*

Gjatë kësaj periudhe disa janë mbështetur me blerjen e materialeve të nevojshme për nisjen e aktiviteteve dhe gjenerimin e të ardhurave. Disa po kryejnë internshipe me pagë të plotë pranë bizneseve private si dhe të tjerë po mbështeten për të zhvilluar një plan biznesi, kjo në bashkëpunim me organizata partnere. Po kështu edhe disa të mbijetuar të tjerë po ndjekin kurse profesionale pranë Qendrës së Formimit Profesional, si dhe kurse të gjuheve të huaja.